



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 17 /12

Datë: 29.08.2012

Në mbështetje të nenit 49, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 70/2010) Mbikëqyrësit e Agjencisë morën këtë:

## V E N D I M

1. **Urdhërohet** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Gjilan, të ndalojë menjëherë vëzhgimin me kamerë në hapësirat e QKMF-së dhe në hapësirat e Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF).
2. Vëzhgimi me kamerë në hapësirat e lartcekura mund të fillojë vetëm pas plotësimit të dispozitave ligjore të parapara me nenet 61 dhe 62 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Në afat prej 15 ditëve të njoftohet Agjencia për zbatimin e vendimit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të vendimit.

## Arsyetim

Më datën 15.08.2012 në Gazetën Ditore 'Kosova Sot' është publikuar një artikull i cili shpjegon për instalimit të kamerave në hapësirat e QKMF-së dhe në disa QMF. Nga artikulli mund të kuptohet se qëllimi i instalimit të kamerave ka qenë shtimi i përgjegjësisë në punë, respektimi i orarit të punës si dhe mënjanimi i tollove pranë ordinancave.

Në bazë të nenit 46, paragrafi 1 dhe nenit 47, paragrafi 1 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), Agjencia ka realizuar inspektimin sipas detyrës zyrtare në QKMF Gjilan më datën 16.08.2012, me qëllim të vërtetimit nëse instalimi i kamerave është në përputhje me LMDHP.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

---

Gjatë inspektimit të lartpërmendur është përpiluar procesverbali me nr. 01/3/2012, i cili është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i QKMF-së të cilit i është dorëzuar një kopje.

Parregullsitë të cilat janë evidentuar në procesverbalin e lartcekur janë :

Institucioni i lartcekur nuk ka nxjerr një vendim për instalimin e kamerave. Sipas nenit 62, paragrafi 2 dhe 3 i LMDHP, obligohen institucionet publike dhe private që para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë të nxjerrin vendim me shkrim. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemit të vëzhgimit me kamerë.

Njoftimi se objekti është në vëzhgimin me kamerë është i vendosur në hyrje si dhe në hapësirat ku bëhet vëzhgimi. Mirëpo, përmbajtja e këtij njoftimi nuk është në përputhje me nenin 61, paragrafi 3, pasi që në këtë njoftim është vendosur emri dhe informacionet për kontakt të kompanisë që ka instaluar kamerat, ndërsa sipas paragrafit të lartcekur në njoftim duhet të jenë informacionet e kontrollorit (QKMF-Gjilan).

Kamerat vëzhgojnë korridoret në të cilat ndodhen ordinancat. Në artikullin gazetës së lartcekur është deklaruar se vëzhgohen tollovitë e pacientëve para ordinancave. Sipas nenit 2 nën-paragrafi 1.1 të LMDHP të dhëna personale konsiderohen informacionet që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë identifikojnë personin fizik, ndërsa sipas nenit 2 nën-paragrafi 1.16 të LMDHP, të dhënat për gjendjen shëndetësore janë të dhëna personale të ndjeshme. Në rastin e vëzhgimit të korridorit në të cilin janë të vendosura ordinancat në mënyrë indirekte ju mund të zbuloni llojin e sëmundjes së pacientit, që e cila është në kundërshtim me LMDHP.

Arsyet për të cilat është instaluar sistemi i vëzhgimit me kamerë sipas përgjegjësve të QKMF-së janë: përcjellja e respektimit të orarit të punës; efikasiteti në punë i stafit shëndetësor duke vëzhguar në kohë reale ordinancat e mjekëve; sigurinë e pajisjeve si dhe sigurinë e personelit. Sipas nenit 62 paragrafi 1 dhe nenit 64 paragrafi 1 të LMDHP, instalimi i sistemeve të vëzhgimit me kamerë mund të bëhet nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës si dhe ruajtjen e informacioneve konfidenciale, nëse ky qëllim nuk arrihet me mjete më të lehta. Vëzhgimi me kamerë në veçanti mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave, ose kur për shkak të natyrës së punës së tyre ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve. Nga sa u tha më lartë, përcjellja e respektimit të orarit të punës dhe efikasiteti në punë i stafit shëndetësor si dy qëllime kryesore të cilat janë paraqitur në procesverbal si dhe në artikullin e gazetës, janë në kundërshtim me LMDHP. Për arritjen e këtyre dy qëllimeve





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

me qëllim të zbatimit të ligjeve përkatëse mund të përdoren mjete tjera por në asnjë mënyrë vëzhgimi me kamerë.

Meqenëse kamerat janë vendosur në pikat ku vëzhgimi ka pasur më shumë qëllime tjera se sa ato të cilat ligji i përcakton, është e domosdoshme që të bëhet rivendosja e kamerave duke plotësuar dispozitat ligjore të LMDHP.

Duke marrë parasysh që QKMF ka të kontraktuar kompani private të sigurimit që kujdeset për sigurinë e pronës dhe të njerëzve, sistemi i vëzhgimit me kamerë mund të jetë një mjet shtesë për të realizuar këtë detyrë dhe nga kjo rrjedh se sistemi i monitorimit në përgjegjësi të tyre.

Sistemi i instaluar i kamerave pamjet i regjistron dhe ruan 14 ditë në HDD, për arritjen e qëllimeve të cilat përcakton ligji, nuk ka nevojë të ketë vëzhgim në kohë reale nga distanca. Vëzhgimi nga distanca në kohë reale nuk mund të bëhet edhe për arsye se është në kundërshtim me nenin 14 nën-paragrafi 1.3.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nenin 49, paragrafi 1.1. dhe 1.3. të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësit shtetërorë kanë marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

### **Këshillë Juridike**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- QKMF Gjilan
- Arkivit të Agjencisë

Mbikëqyrës Shtetërorë  
Državni Nadzornici

Aleksandar Spasić  
Bekim Demiri

